



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

INSPEKTORIATI SHTETËROR I PUNËS
DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Nr. 1031 Prot.
Tiranë, më 28.022019

Nr. 458 Prot
Tiranë, më 28.02.2019

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i përfaqësuar nga Kryetari z. Gentian Sala, dhe **Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)**, përfaqësuar nga Kryeinspektori z. Arben Seferaj, që më poshtë ju referohemi me termin “Palët”:

Në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës”, i ndryshuar,

Me qëllim garantimin e zbatimit të dispozitave ligjore për kushtet e punës, mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, pagat, sigurimin dhe mirëqënien në sektorin e mediave audiovizive,

Shprehin gatishmërinë të rrisin dhe forcojnë bashkëpunimin, për çështje të interesit të përbashkët që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e punëmarrësve në fushën e mediave audio dhe/ose audiovizive.

Palët e këtij Memorandumi Bashkëpunimi (më poshtë “**Memorandumi**”) bien dakord të bashkëpunojnë me qëllim të shkëmbimit të përvojës dhe informacionit si më poshtë vijon:

Neni 1

Shkëmbimi i informacionit

1. AMA dhe ISHPSHSH shkëmbejnë informacionin e nevojshëm, të cilin pala marrëse e ruan me të njëjtin nivel konfidencialiteti, si pala dërguese.
2. Shkëmbimi i informacioneve bëhet sipas përcaktimeve në ligjet respektive të mbrojtjes së punës dhe për mediat audiovizive, Kodit të Procedurave Administrative dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në momentin e nënshkrimit të këtij memorandumi.

3. Procesi i shkëmbimit të informacionit do të bazohet në parimin e besueshmërisë reciproke, transparencës mes palëve për aq sa e lejon legjislacioni në fuqi, efikasitetit në përshpejtimin e kohës së shkëmbimit të informacionit dhe vullnetit pozitiv për të vënë në dispozicion informacionin e disponueshëm konform legjislacionit.
4. Secili nga palët duhet të garantojë konfidencialitetin e marrë nga pala tjetër. Informacioni i marrë në kuadër të këtij memorandumi nuk mund të transferohet një pale të tretë pa pasur një autorizim me shkrim nga pala e cila ka siguruar informacionin.

Neni 2 Fushat e bashkëpunimit

1. AMA dhe ISHPSHSH do të bashkëpunojnë në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës”, i ndryshuar, në hartimin e akteve nënligjore, rregulloreve dhe udhëzuesve lidhur me mbrojtjen e punëmarrësve të punësuar në fushën e mediave audio dhe/ose audiovizive.
2. AMA dhe ISHPSHSH do të bashkëpunojnë dhe do të shkëmbejnë informacion në fushën e punës për të dhëna që secila palë disponon.

Neni 3 Organizimi i konferencave

Palët kur është e përshtatshme do të informojnë dhe do të ftojnë në workshope, seminare dhe konferenca kombëtare dhe/ose ndërkombëtare të organizuara nga palët, Komisioni European, OECD etj. apo autoritetet simotra të vendeve të rajonit, BE e më gjerë.

Neni 5 Koherenca e takimeve mes palëve

Titullarët e palëve respektive do të takohen në rast nevojë për sa i përket zbatimit të këtij memorandumi në mënyrë që të rendisin prioritetet e bashkëpunimit brenda kësaj kornize dhe vazhdimin e tij, shkëmbim pikëpamjesh dhe ato sipas mundësive, do të ndër marrin veprime dhe pozicione të përbashkëta në forume dhe organizata evropiane ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me sektorin e mediave audiovizive.

Neni 6 Pikat e kontaktit

1. Në dhe për zbatim të kësaj marrëveshje, personat e kontaktit do të jenë:
 - a. Për Inspektoriatin Shtetëror të punës dhe Shërbimeve Shoqërore
Z. Ervis Bedo/ email: Ervis.Bedo@sli.gov.al
 - b. Për Autoritetin e Mediave Audiovizive
Z. Eriona Rusmali/ email: eriona.rusmali@ama.gov.al

Neni 7
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Memorandumi hyn në fuqi në datën e poshtëshënuar dhe mund të ndërpritet nga secila palë, duke njoftuar palën tjetër paraprakisht në një afat kohor prej 1(një) muaji.

U firmos dhe hyn në fuqi në datë _____.____.2019.

PËR

**AUTORITETIN E MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

KRYETAR

GENTIAN SALA



PËR

**INSPEKTORIATIN SHTETËROR TË
PUNËS DHE SHËRBIMEVE
SHOQËRORE**

KRYEINSPEKTOR

ARBEN SEFERAJ